

**Nga: Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN Kosova)**

**Për:** Drejtorin e KPMM-së, Ramiz Krasniqi

Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN Kosova) në kuadër të bashkëpunimit me Ambasadën Britanike është duke punuar në inkurajimin e institucioneve publike për të rritur nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.

Në fund të vitit të kaluar, BIRN Kosova e ka prodhuar një analizë të raporteve të auditimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Përveç analizave janë mbajtur edhe disa debate nëpër komuna, ku ka marrë pjesë edhe Zyra Kombëtare e Auditimit, të cilët kanë ofruar asistencë institucioneve në hartim të planeve për zbatimin të rekomandimeve, të cilën ndihmë ju inkurajojmë që ta shfrytëzoni.

Në këtë shkresë janë pasqyruar rekomandimet e përsëritura nëpër vite dhe çalimet në fusha specifike. Të bashkangjitura i keni edhe rekomandimet e dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

Duke marrë parasysh se punët në zbatimin e rekomandimeve janë në përfundim, kjo letër është sinjalizim shtesë për rëndësinë e zbatimit të plotë të rekomandimeve apo fillimin e zbatimit të rekomandimeve që marrin më shumë se 1 vit për t'u zbatuar.

Më poshtë gjeni vetëm disa prej shumë rekomandimeve që keni marrë nga Auditori.

- *Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se ndërmerren masat e duhura për të shtuar përgjegjësinë dhe efikasitetin e mekanizmave përkatës, për të siguruar informata të plota lidhur me vëllimin e mineraleve të prodhuara dhe aktivitetin e shfrytëzuesve të licencave, ashtu siç përcaktohet me ligjin në fuqi.*
- *Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme koordinuese dhe efikase nëpërmjet organeve shtetërore, në mënyrë që të ndikojnë në ndalimin e aktiviteteve ilegale dhe të analizojë efektivitetin e mekanizmave për mbledhjen e gjobave.*
- *Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar për adresimin e rekomandimeve të mbetura të vitit 2015 dhe ato të vitit 2016. Ky plan duhet të përcaktojë afatet e arsyeshme kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar.*
- *Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që të gjendet një zgjidhje e përshtatshme për plotësimin e pozitës së zyrtarit certifikues, sipas LMFP-së.*

Ne do të vijmë në një vizitë në institucionin tuaj për të biseduar për telashet që i keni në zbatim të rekomandimeve si dhe për të parë secilin rekomandim se në cilën fazë është aktualisht: është realizuar plotësisht, është në proces të zbatimit apo nuk është zbatuar fare.

**ANEKS**

**Rekomandimet e Auditorit për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, që janë pjesë e raportit të Auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin e përfunduar me datën 31 dhjetor 2017.**

Nr.	Rekomandimet e Auditorit në raportin e Auditimit për PVF - 31.12.2017	Plotësisht	Në proces	Të pa-adresuara
1	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ndërmerren masat e duhura për të shtuar përgjegjësinë dhe efikasitetin e mekanizmave përkatës, për të siguruar informata të plota lidhur me vëllimin e mineraleve të prodhuara dhe aktivitetin e shfrytëzuesve të licencave, ashtu siç përcaktohet me ligjin në fuqi.			
2	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj ndërmarrjen e veprime të menjëhershme koordinuese dhe efikase nëpërmjet organeve shtetërore, në mënyrë që të ndikojnë në ndalimin e aktiviteteve ilegale. Po ashtu duhet ta analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e gjobave, si dhe të propozoj masa dhe procedura plotësuese që kanë ndikim direkt në ndalimin e operimeve ilegale, inkasimin e borxheve dhe mbrojtjen e pasurisë së vendit.			
3	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që të gjendet një zgjidhje e përshtatshme për plotësimin e pozitës së zyrtarit certifikues, sipas LMFPP-së.			
4	Kryesuesi i Bordit duhet të forcoj kontrollet në menaxhimin e pasurisë, duke bërë regjistrimet e duhura dhe larguar nga regjistri gjithë pasurin e dhuruar dhe të asgjësuar në mënyrë që prezantimi i pasurisë në PVF në fund vit të jetë i saktë dhe e plotë			
5	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj ndërmarrjen e masave të duhura, përfshirë veprimet ligjore në mënyrë që të shtoj efikasitetin në inkasimin e llogarive të arkëtueshme.			
6	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar për adresimin e rekomandimeve të mbetura të vitit 2015 dhe ato të vitit 2016. Ky plan duhet të përcaktoj afatet e arsyeshme kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar. Progresi kundrejt planit duhet të monitorohet në mënyrë sistematike nga menaxhmenti për të siguruar zbatimin e plotë të rekomandimeve.			

Nr.	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016 (Të evidentuara në fund të raportit të auditimit për 2017)	Plotësisht	Në proces	Të pa-adresuara
1	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që plani i veprimit, duhet të rishikohet duke i analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara dhe të përcaktojë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve të mbetura, me anëtarët e stafit llogaridhënës dhe me fokus fillestar në fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.			
2	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ndërmerren veprime adekuate për të shtuar përgjegjësinë e raportimit duke ngritur efikasitetin me qëllim të sigurimit të informatave të plota lidhur me sasinë e mineraleve të prodhuara dhe aktivitetin e shfrytëzuesve të licencave, ashtu siç përcaktohet me kornizën ligjore.			
3	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj koordinim efikas ndërmjet mekanizmave shtetërore për të parandaluar plotësisht operimet ilegale. Po ashtu, duhet të shqyrtohet mundësia që inkasimi i gjobave të bëhet përmes përmburuesve privat si një mekanizëm më efikas në mbledhjen e gjobave, sepse kjo do të ketë ndikim direkt në parandalimin e operimeve ilegale.			
4	Kryesuesi i bordit duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë që proceset e menaxhimit të pasurisë janë transparente dhe bëhen në përputhje të plotë me rregullën për menaxhimin e pasurive, duke harmonizuar gjendjen e pasurive me gjendjen e dalë nga inventarizimi			
5	Kryesuesi i Bordit duhet të rishikojë politikat dhe rregulloret e KPMM-së me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve duke marrë të gjitha masat në pajtim me rregulloret dhe ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.			